

# Ligj për inspeksionin arsimor

TEKST I KONSOLIDUAR ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/2005, 81/2008, 148/2009, 57/2010, 51/2011, 24/2013, 137/2013, 164/2013, 41/2014, 33/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 64/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 3/2025).

## 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë ligj rregullohet organizimi, kompetencat dhe autorizimet e inspeksionit arsimor, të cilin e kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe inspektorët e autorizuar të komunës dhe të Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: inspektorët arsimorë).

### Neni 2

Kryerja e mbikëqyrjes inspektuese arsimore përfshin mbikëqyrjen e cilësisë të procesit arsimor dhe efektivitetit përmes evoluimit të punës së institucioneve edukativo-arsimore në arsimin fillor dhe të mesëm dhe mbikëqyrjen mbi zbatimin e ligjeve, rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme nga sfera e edukimit dhe arsimit.

Mbikëqyrja inspektuese arsimore bëhet në: shkollat fillore, në shkollat e mesme, në kopshtet e fëmijëve, në institucionet për arsimimin e të rriturve, në institucionet për arsimimin dhe aftësimin e nxënësve me nevoja arsimore të posaçme (në tekstin e mëtejme: institucione edukativo-arsimore). Në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore, mbikëqyrja inspektuese bëhet mbi zbatimin e ligjeve me të cilat rregullohet veprimtaria e arsimit sipëror dhe veprimtaria shkencore, për çështje të përcaktuara me këtë ligj.

Mbikëqyrja inspektuese bëhet edhe mbi zbatimin e ligjeve, rregullave dhe akteve të tjera me të cilat rregullohen konviktet e nxënësve dhe studentëve.

Në procedurën gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat nga Ligji për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

## 2. VËNIA ORGANIZATIVE E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË ARSIMIT

### Neni 3

*I fshirë*

## Neni 4

Inspektorati Shtetëror i Arsimit, organizohet në përputhje me kompetencat e tij dhe në përputhje me ligjin dhe me rregullat tjera me forma organizative rajonale sipas rrjetit të shkollave dhe të gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi.

Më për së afërmi, vënia organizative e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit do të rregullohet me akt të veçantë për organizimin.

Në aktin për sistematizimin e vendeve të punës së Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive në përputhje me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë bashkëpunon me Byronë për Zhvillimin e Arsimit, me organet e komunës, gjegjësisht Qytetit të Shkupit, me këshillat shkollorë, me këshillat e prindërve si edhe me organet dhe institucionet e tjera kompetente.

## Neni 5

Inspektoratin Shtetëror të Arsimit e udhëheq drejtori të cilin me propozim të ministrit të Arsimit dhe të Shkencës (në tekstin e mëtejme: ministri) e emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Në mungesë të drejtorit, atë e zëvendëson nëpunësi shtetëror udhëheqës i cili bën mbikëqyrje inspektuese, të cilin ai do ta caktojë.

Për emërimin e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit publikohet shpallje publike në së paku tre gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Për drejtor të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/I të arsimit; 4) ka së paku pesë vjet përvojë pune si mësimdhënës, bashkëpunëtorë profesional ose sekretar në shkollë fillore, përkatësisht shkollë të mesme ose në organin e administratës kompetent për punët nga sfera e arsimit.
- 5) të ketë vërtetim ose certifikatë të dhënies së provimit për njohjen e njërës prej katër gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe

italisht) në nivelin B2 të Kornizës Europiane të Referencës për Gjuhët, të lëshuar nga një institucion në shtet ose jashtë vendit, të regjistruar si ofruar i këtij shërbimi, jo më shumë se pesë vjet, me përjashtim të mësimdhënësve të lëndës gjuhë angleze, frënge, gjermane dhe italiane.

Mandati i drejtorit zgjat katër vjet, me të drejtë edhe për një mandat tjetër të njëpasnjëshëm.

### **Neni 5-a**

(1) Drejtori përpilon propozim-program vjetor për punë të inspektoratit dhe atë e dorëzon te Këshilli inspektues më së voni deri më 31 tetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(2) Drejtori e miraton programin vjetor për punë të inspektoratit në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të pëlqimit nga Këshilli inspektues, përkatësisht më së voni deri më 10 dhjetor të vitit rrjedhës nëse Këshilli inspektues nuk e shqyrton dhe nuk dorëzon pëlqim, respektivisht vërejtje në afatin e përcaktuar me ligj.

(3) Në bazë të programit të miratuar vjetor, drejtori përpilon plane tremujore për punën e çdo inspektori, të cilat në mënyrë përmbledhëse i dorëzon për shqyrtim te Këshilli inspektues më së voni dy javë para fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik edhe atë deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë nga viti i ardhshëm, deri më 15 mars për tremujorin e dytë, deri më 15 qershor për tremujorin e tretë, respektivisht deri më 15 shtator për tremujorin e katërt të vitit rrjedhës.

(4) Në planet tremujore për punë për çdo inspektor, drejtori detyrimisht e fut numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara për tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e ndërlíkueshmërisë së secilës prej mbikëqyrjeve.

(5) Në bazë të planeve tremujore, për çdo inspektor, drejtori përpilon plan mujor për punë, plan i cili përmban edhe orar të mbikëqyrjeve sipas datave dhe sipas subjekteve të mbikëqyrjes.

(6) Drejtori, më së voni dy javë nga fillimi i tremujorit kalendarik rrjedhës për atë paraprak, te Këshilli inspektues dorëzon në mënyrë përmbledhëse raporte tremujore për punën e çdo inspektori, edhe atë deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit paraprak, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për tremujorin e dytë, respektivisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

(7) Drejtori, më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës, te Këshilli inspektues dorëzon raport vjetor për punën e inspektoratit për vitin paraprak.

## **Neni 6**

Mbikëqyrjen inspektuese, në suazat e kompetencës së Inspektoratit Shtetëror të Arsimit e bëjnë Inspektorët shtetërorë të arsimit.

## **Neni 7**

Inspektor mund të jetë personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- është i moshës madhore,
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- nuk i është shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose arsim të mbaruar shkallë VII/1 për mësimdhënës, që dëshmohet me certifikatë ose diplomë,
- ka pesë vjet përvojë pune në profesion në institucione edukative-arsimore të verifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
- i plotëson kushtet tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës,
- posedon vërtetim për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe
- ka licencë për inspektor nga sfera e kompetencës të shërbimit inspektues.

## **3. KOMPETENCAT E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË ARSIMIT**

### **Neni 8**

Inspektorati Shtetëror i Arsimit e mbikëqyr përmbushjen e standardeve arsimore, sigurimin e cilësisë në arsim, efektivitetin përmes evoluimit të punës së institucioneve edukativo-arsimore si edhe zbatimin e ligjeve, të rregullave dhe akteve të përgjithshme nga sfera e edukimit dhe e arsimit.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit kryen mbikëqyrje në institucionet edukativo-arsimore. Në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit e mbikëqyr zbatimin e ligjeve me të cilat rregullohet veprimtaria e arsimit sipëror, për çështje të përcaktuara me këtë ligj.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit e mbikëqyr edhe zbatimin e ligjeve, zbatimin e rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme me të cilat rregullohen konviktet e nxënësve dhe të studentëve.

### **Neni 9**

Inspektorati Shtetëror i Arsimit kryen mbikëqyrje mbi:

- 1) ekzistimin e kushteve për kryerjen e veprimtarisë në institucionet edukativo-arsimore, në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore, në konviktet e nxënësve dhe të studentëve;
- 2) realizimin e procesit edukativo-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- 3) kushtet e posaçme për zgjedhjen e arsimtarëve, zgjedhjen e bashkëpunëtorëve dhe edukatorëve profesionalë;
- 4) përsosjen profesionale dhe pedagogjike të arsimtarëve, të bashkëpunëtorëve dhe të edukatorëve dhe dhënien e provimit profesional;
- 5) përdorimin e teksteve mësimore në shkollat fillore dhe të mesme;
- 6) procedurën për zgjedhjen në tituj arsimor, arsimorë-shkencor, shkencor dhe bashkëpunëtor;
- 7) administrimin dhe udhëheqjen e institucioneve edukativo-arsimore për arsim të mesëm, të themeluara nga shteti dhe shkollat e mesme private;
- 8) realizimin e planeve dhe programeve mësimore, dhe standardet dhe normativat e tjera të përcaktuara, me të cilat rregullohet veprimtaria edukativo-arsimore;
- 9) realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore;
- 10) realizimin e programeve eksperimentale në institucionet edukativo-arsimore;
- 11) realizimin e konkursit për regjistrimin e nxënësve dhe të studentëve dhe të konkursit për vendosjen e nxënësve dhe studentëve në konviktet e nxënësve dhe të studentëve;
- 12) mbajtjen e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik si edhe lëshimin dhe përdorimin e tyre në arsimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm dhe arsimin sipëror dhe në konviktet e nxënësve dhe të studentëve;
- 13) mbajtjen e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik në formë elektronike dhe mbajtjen e e-ditarit në bazë javore në arsimin fillor dhe të mesëm;
- 14) zbatimin e normativave për numrin e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve të duhur dhe për madhësinë e grupit të studentëve të rregullt në institucionet e arsimit sipëror;
- 15) procedurën për miratimin e programeve studimore në arsimin sipëror;
- 16) përcjelljen e procesit edukativo-arsimor në kohë greve në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- 17) kontrollin e mjeteve të fituara nga burimet vetjake në institucionet e arsimit të mesëm, të themeluara nga shteti;
- 18) zbatimin e rregullativës ligjore në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore dhe
- 19) zbatimin e rregullativës ligjore nga fusha e ndalimit dhe pengimit të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar në institucionet edukativo-arsimore, në institucionet e arsimit të lartë dhe në institucionet shkencore.

#### **4. INSPEKTORËT ARSIMORË TË AUTORIZUAR TË KOMUNËS DHE TË QYTETIT TË SHKUPIT**

**Neni 10**

Kryetari i komunës, gjegjësisht i Qytetit të Shkupit, mund të autorizojë person nga administrata e komunës, gjegjësisht nga administrata e Qytetit të Shkupit, për kryerjen e inspeksionit arsimor (në tekstin e mëtejme: inspektor i autorizuar arsimor).

Kushtet nga neni 7 të këtij ligji i dedikohen edhe inspektorit të autorizuar të komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

Inspektori i autorizuar arsimor e mbikëqyr ligjshmërinë e kryerjes së punëve nga sfera e arsimit në kompetencën e komunës, gjegjësisht Qytetit të Shkupit, në përputhje me ligjin.

Inspektori i autorizuar arsimor bën mbikëqyrje mbi:

- 1) kushtet dhe procedurën e themelimit dhe pushimit nga puna në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht nga Qyteti i Shkupit;
- 2) kushtet për punë të institucioneve edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit;
- 3) regjistrimin e nxënësve në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit;
- 4) përfshirjen e nxënësve në përputhje me rajonizimin e shkollave fillore;
- 5) transportin, ushqimin dhe vendosjen e nxënësve në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit;
- 6) kushtet për zgjedhjen e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit;
- 7) procedurën për formimin e organeve të shkollës në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit; dhe
- 8) kontrollin e mjeteve të fituara nga burimet vetjake në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit.

## **Neni 11**

Në qoftë se kryetari i komunës gjegjësisht i Qytetit të Shkupit, nuk ka autorizuar inspektor arsimor për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, të njëjtat do t'i kryejë Inspektori Shtetëror i Arsimit në llogari të komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit, deri në autorizimin e inspektorit arsimor.

Në qoftë se kryetari i komunës gjegjësisht i Qytetit të Shkupit, ka autorizuar inspektor arsimor për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, ndërsa i njëjti nuk i kryen, në atë rast punët do t'i kryejë Inspektori shtetëror i arsimit në llogari të komunës gjegjësisht të Qytetit të Shkupit.

## **5. LEGJITIMACIONI I INSPEKTORIT ARSIMOR**

### **Neni 12**

Autorizimin për kryerjen e mbikëqyrjes, Inspektori shtetëror i arsimit dhe inspektori i autorizuar arsimor e konfirmon me legjitimacion.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit nga paragrafi 1 i këtij neni dhe mënyrën e lëshimit dhe të heqjes së tij e përcakton ministri.

Legjitimacionin e Inspektorit shtetëror të arsimit e lëshon ministri ndërsa legjitimacionin e inspektorit të autorizuar arsimor e lëshon kryetari i komunës gjegjësisht i Qytetit të Shkupit.

### **Neni 13**

Inspektorët arsimorë, gjatë kohës së punës së tyre, janë të obliguar që të përsosen profesionalisht në mënyrë permanente, në përputhje me ligjin.

## **6. KRYERJA E MBIKËQYRJES INSPEKTUESE**

### **Neni 14**

Institucionet edukativo-arsimore, institucionet e arsimit sipëror dhe institucionet shkencore, konviktet e nxënësve dhe të studentëve, janë të obliguara që të mundësojnë mbikëqyrje dhe me kërkesë të Inspektorit, t'ia dorëzojnë të dhëna për kryerjen e mbikëqyrjes, në afat prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të kërkesës.

### **Neni 15**

Drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, miraton Program vjetor për punën e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe e organizon realizimin e tij.

Kryetari i komunës gjegjësisht i Qytetit të Shkupit, miraton Program vjetor për punën e inspektorit arsimor të autorizuar dhe e organizon realizimin e tij.

Drejtori, në fund të vitit kalendarik përpilon Raport vjetor për punën e Inspektoratit dhe ia dërgon ministrit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Raporti për punën është i arritshëm për publikun.

Kryetari i komunës gjegjësisht i Qytetit të Shkupit, përpilon Program vjetor për punën e inspektorit arsimor të autorizuar. Raporti për punën është i arritshëm për publikun.

Raportet nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, përmbajnë:

- 1) vlerësim për cilësinë e procesit arsimor dhe efektivitetin përmes evoluimit të punës së institucioneve edukativo-arsimore;
- 2) vlerësim të përgjithshëm të gjendjeve nga aspekti i respektimit të ligjshmërisë nga ana

e institucioneve edukativo-arsimore, institucioneve të arsimit sipëror dhe institucioneve shkencore;

3) të dhëna për numrin e mbikëqyrjeve të kryera në institucione të veçanta edukativo-arsimore, institucione të arsimit sipëror dhe në institucione shkencore;

4) të dhëna për cenimet e konstatuara dhe masat e shqiptuara, si edhe për zbatimin e masave të shqiptuara;

5) rekomandime për përmirësimin e gjendjeve të konstatuara; dhe

6) të dhëna të tjera me rëndësi për punën e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit gjegjësisht për inspektorin arsimor të autorizuar.

## **Neni 16**

Drejtori i Inspektoratit Shtetëror i Arsimit gjegjësisht nëpunësi shtetëror udhëheqës për mbikëqyrjen inspektuese nga neni 5 i këtij ligji, është i obliguar që:

- ta mbikëqyrë punën e inspektorëve shtetërorë të arsimit;

- ta harmonizojë punën e inspektorëve shtetërorë të arsimit, dhe

- të japë instruksione të domosdoshme për punën e inspektorëve shtetërorë të arsimit, ndihmë profesionale dhe tjetër,

- drejtori miraton program vjetor të punës së Inspektoratit më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm.

## **Neni 17**

Nëse për konstatimin ose për vlerësimin e ndonjë fakti i cili është me rëndësi për zgjedhjen e lëndës, nevojitet njohuri plotësuese profesionale, prova mund të nxirret edhe me ndihmën e personit profesional nga fusha përkatëse.

Si person profesional, sipas këtij ligji nënkuptohet personi i cili ka njohuri të thella profesionale.

Listën e personave profesionalë e përcakton ministri.

Personin profesional do ta përcaktojë drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, përkatësisht inspektori arsimor i autorizuar nga lista e personave profesionalë.

Personi profesional përgatit mendim me shkrim dhe ia dërgon inspektorit kompetent.

Personi profesional duhet ta dijë edhe gjuhën e pjesëmarrësve në procedurën e mbikëqyrjes.

## **Neni 18**



Inspektori është i obliguar që gjatë punës së tij dhe pas pushimit me punë, t'i ruajë të gjitha të dhënat të cilat i ka kuptuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, e të cilat paraqesin informacione të klasifikuara me shkallë përkatëse fshehtësie, të përcaktuar me ligj.

Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni vlejnë edhe për personat profesionalë.

## **7. MËNYRA DHE PROCEDURA E KRYERJES SË MBIKËQYRJES INSPEKTUESE**

### **Neni 19**

Inspektori shtetëror i arsimit mbikëqyrjen e kryen përmes:

- evoluimit integral të institucioneve edukativo-arsimore,
- inspektimit të rregullt,
- mbikëqyrjes së jashtëzakonshme,
- mbikëqyrjes kontrolluese.

### **Neni 20**

Evoluimi integral i institucionit edukativo-arsimor përfshin: organizimin dhe realizimin e mësimit, kushtet dhe kulturën në institucionet edukativo-arsimore, menaxhimin, përmbushjen dhe vlerësimin e detyrave të punës të mësimeve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, zhvillimin profesional të kuadrove edukativo-arsimore dhe kuadrove udhëheqëse, komunikimin dhe marrëdhëniet me opinionin, bashkëpunimin me prindërit dhe mjedisin dhe ngjashëm.

Gjatë zbatimit të evakuimit integral në shkolla fillore dhe të mesme, në pjesën e vlerësimit të mësimeve, e me kërkesë paraprake të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, është i pranishëm edhe përfaqësuesi i Byrosë për Zhvillim të Arsimit.

Evoluimi integral nga paragrafi 1 i këtij neni, kryhet në çdo vit të tretë shkollor.

Për evoluimin e realizuar integral nga paragrafi 1 i këtij neni, Inspektorati Shtetëror i Arsimit përpilon raport me shkrim për punën e mësimeve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, nga shkollat fillore dhe të mesme dhe ia dorëzon shkollës dhe Qendrës Shtetërore të Provimeve.

### **Neni 21**

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme bëhet në bazë të iniciativës nga ana e nxënësve, studentëve, prindërve, Këshillit të prindërve, të punësuarve në institucionin edukativo-arsimor dhe nga qytetarë të tjerë.

### **Neni 22**

Mbikëqyrja kontrolluese realizohet pas skadimit të afatit të përcaktuar nga inspeksioni, për mënjanimin e mangësive.

### **Neni 23**

Mbikëqyrjen e jashtëzakonshme dhe kontrolluese mund ta bëjë edhe inspektori i autorizuar arsimor në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna gjegjësisht Qyteti i Shkupit.

### **Neni 24**

Procedura e evoluimit integral zhvillohet në tri faza:

- a) faza përgatitore,
- b) faza e implementimit (realizimit),
- c) faza e lajmërimit.

### **Neni 25**

Para se të realizohet vizita në institucionin edukativo-arsimor, inspektori shtetëror i arsimit me shkrim e lajmëron drejtorin e institucionit edukativo-arsimor, Këshillin shkollor dhe Këshillin e prindërve për qëllimin e tij.

Inspektori shtetëror i arsimit, paraprakisht merret vesh me drejtorin e institucionit edukativo-arsimor për qëllimet e vizitës së tij, si dhe për programin e vizitave të tij në orët individuale të arsimtarëve.

Inspektori shtetëror i arsimit i dërgon institucionit edukativo-arsimor pyetësor të standardizuar i cili përmban informata të rëndësishme për Inspektoratin.

Pyetësori duhet të plotësohet nga ana e drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe i dërgohet inspektorit në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të pyetësorit.

Mbikëqyrja inspektuese duhet të realizohet në afat prej 22 ditësh pas pranimit të përgjigjes së pyetësorit nga ana e institucionit edukativo-arsimor.

### **Neni 26**

Pas mbikëqyrjes së kryer, inspektori mban mbledhje me personat përgjegjës të institucionit edukativo-arsimor gjatë së cilës e informon për të dhënat dhe përfundimet paraprake.

Inspektori arsimor shtetëror përpilon Raport dhe ia dërgon institucionit edukativo-arsimor.

Raporti me shkrim përmban: hyrje, të dhënat kryesore për shkollën, të dhënat për punën e shkollës, anët e mira dhe të dobëta, rekomandimet dhe rezyme.

Raporti me shkrim, në formë projekti i dërgohet institucionit edukativo-arsimor, i cili duhet të prononcohet për raportin në afat prej 15 ditësh.

Këshilli shkollor përgatit plan aksional për aktivitetet të cilat ai i propozon si përgjigje të mbikëqyrjes inspektuese. Plani i përmban aktivitetet të cilat shkolla do t'i ndërmarrë që të arrijë përmirësim si përgjigje në problematikën e cekur në raportin inspektues.

Pas pranimit të përgjigjes nga institucioni edukativo-arsimor dhe pas sqarimit të momenteve kontestuese përkatëse në raport, raporti miratohet nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit. I njëjti i dërgohet institucionit edukativo-arsimor, Këshillit të shkollës, Këshillit të prindërve, kryetarit të komunës, gjegjësisht të Qytetit të Shkupit, Ministrisë dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.

Raporti është i arritshëm për opinionin ndërsa rezymeja nga raporti shpallet në internet në faqen zyrtare të Ministrisë.

#### **Neni 26-a**

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i arsimit ose inspektori i autorizuar komunal i arsimit, përkatësisht i qytetit të Shkupit, përcakton se për herë të parë është kryer parregullsi nga neni 36 paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, ka për detyrë që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzimin e njëkohshëm të ftesës për zbatimin e edukimit të personit ose personit juridik ku është përcaktuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit i përcakton ministri.

Edukimin e organizon dhe zbaton Inspektorati Shtetëror i Arsimit, përkatësisht inspektori i autorizuar komunal i arsimit/qytetit të Shkupit, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese.

Edukimi mund të zbatohet për më shumë parregullsi të njëjta ose të ngjashme të përcaktuara për një ose më shumë persona përkatësisht për një ose më shumë persona juridikë.

Nëse në terminin e caktuar personi ose personi juridik mbi të cilin zbatohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është zbatuar.

Nëse personi ose personi juridik mbi të cilin zbatohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen atë, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e përcaktuar.

Nëse inspektori shtetëror i arsimit, përkatësisht inspektori i autorizuar komunal i arsimit/qytetit të Shkupit gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin, e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

Nëse inspektori shtetëror i arsimit, ose inspektori i autorizuar komunal i arsimit/qytetit të Shkupit gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit, përkatësisht inspektori i autorizuar komunal i arsimit/qytetit të Shkupit i cili ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, mban evidencë për edukimin e kryer në mënyrë të përcaktuar nga ministri.

#### **Neni 26-b**

Inspektorati Shtetëror i Arsimit, përkatësisht inspektori i autorizuar komunal i arsimit/Qytetit të Shkupit për kontrollet e kryera përgatit raporte tremujore dhe i publikon në ueb faqen e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, për pasqyrë të unifikuar tremujore.

#### **Neni 27**

Mënyrën dhe procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, më për së afërmi do t'i përcaktojë ministri.

### **8. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E INSPEKTORIT ARSIMOR**

#### **Neni 28**

Inspektori shtetëror i arsimit, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes është i autorizuar të:

- 1) mbikëqyrë cilësinë e punës edukativo-arsimore përmes evoluimit;
- 2) të bëjë inspektim në zbatimin e ligjeve, rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme në institucionet edukativo-arsimore shtetërore dhe private, në konviktet e nxënësve dhe studentëve, në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore dhe për këtë të kërkojnë të dhëna të duhura;
- 3) paralajmërojë për zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tjera gjegjësisht, mënjanimin e mangësive të konstatuara që dalin nga zbatimi i masave joligjore ose nga cenimi i ligjit

dhe i rregullave të tjera në institucionet edukativo-arsimore shtetërore dhe private, në konviktet e nxënësve dhe të studentëve, në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore;

4) pengojë zbatimin e masave, veprimeve, punëve dhe procedurave joligjore në institucionet edukativo-arsimore shtetërore dhe private, në konviktet e nxënësve dhe të studentëve, në institucionet e arsimit sipëror dhe në institucionet shkencore;

5) propozojë ngritjen e procedurës për anulimin e provimeve gjatë zbatimit të të cilave janë cenuar rregullat dhe zhvleftësimin e dëftesave, diplomave dhe dokumenteve të tjera publike të marra nga ato provime;

6) propozojë ngritjen e procedurës për zhvleftësimin e dëftesave, vërtetimeve dhe diplomave të lëshuara nga institucionet edukativo-arsimore të cilat nuk kanë leje për punë;

7) lëshojë ndalesë të përkohshme për shfrytëzimin (gjegjësisht) përdorimin e dëftesave, vërtetimeve dhe diplomave të kontestuara, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për vlefshmërinë e tyre;

8) propozojë ngritjen e procedurës disiplinore kundër të punësuarve në institucionet edukativo-arsimore shtetërore dhe private, në konviktet e nxënësve dhe studentëve, në institucionet e arsimit sipëror dhe institucionet shkencore;

9) propozojë largimin nga vendi i punës në rastet e përcaktuara me këtë ligj;

10) propozojë prishjen e notës dhe përcaktimin e kontrollit të përsëritur të diturisë dhe të notimit të nxënësit; dhe

11) lajmëron themeluesin e institucionit edukativo-arsimor për konstatimet e mbikëqyrjes së kryer inspektues për rastet kur nevojitet mënjanimi i cenimeve të karakterit të atillë të cilat nuk durojnë shtyrje dhe e rrezikojnë jetën dhe shëndetin e fëmijëve, nxënësve, studentëve dhe punonjësve në procesin edukativo-arsimor.

## Neni 29

Inspektori i autorizuar arsimor, gjatë mbikëqyrjes është i autorizuar të:

1) bëjë inspektim në zbatimin e ligjeve, rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna gjegjësisht Qyteti i Shkupit dhe për këtë të kërkojnë të dhëna të duhura;

2) udhëzojë për zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tjera gjegjësisht, mënjanimin e mangësive të konstatuara që dalin nga zbatimi i masave joligjore ose nga cenimi i ligjit dhe rregullave të tjera në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna gjegjësisht nga Qyteti i Shkupit;

3) pengojë zbatimin e masave, veprimeve, punëve dhe procedurave joligjore në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit;

4) propozojë ngritjen e procedurës disiplinore kundër të punësuarve në institucionet edukativo-arsimore të themeluara nga komuna, gjegjësisht Qyteti i Shkupit;

5) propozojë largimin nga vendi i punës në rastet e përcaktuara me këtë ligj;

6) lajmëron Këshillin e komunës gjegjësisht Këshillin e Qytetit të Shkupit për konstatimet

nga mbikëqyrja e kryer inspektuese për rastet kur nevojitet mënjanimi i cenimeve të karakterit të atillë të cilat nuk durojnë shtyrje dhe e rrezikojnë jetën dhe shëndetin e fëmijëve, të nxënësve, të studentëve dhe të punësuarve në procesin edukativo-arsimor.

### **Neni 30**

Inspektori arsimor, i propozon organit udhëheqës të institucionit edukativo-arsimor, konviktit të nxënësve dhe të studentëve, institucionit për arsim sipëror dhe institucionit shkencor, masë largim i të punësuarit nga vendi i punës në qoftë se në bazë të fakteve, gjatë mbikëqyrjes ka konstatuar se ekziston dyshim i bazuar se arsimtari dhe të punësuarit të tjerë në procesin edukativo-arsimor kanë bërë cenim me atë që:

- janë të varur nga droga gjegjësisht nga alkooli,
- nxisin nxënësit, studentët të konsumojnë drogë ose të konsumojnë alkool, ose të njëjtëve u kanë shitur drogë ose alkool,
- nuk ndërmerr masa për pengimin e nxënësve dhe të studentëve nga marrja e drogës, përkatësisht konsumimi i alkoolit, nëse kanë ditur për një dukuri të këtillë në institucionet edukativo-arsimore,
- bëjnë maltretim fizik dhe psikik mbi fëmijët, nxënësit dhe studentët,
- nxisin kah keqpërdorimi seksual ose seksualisht e keqpërdorin nxënësin, studentin ose të punësuarin,
- bëjnë cenim gjatë arkëtimit dhe shpërndarjes së mjeteve financiare.

Inspektorati Shtetëror, organit i cili e zgjedh drejtorin e institucionit edukativo-arsimor, institucionit të lartë arsimor dhe shkencor, konviktit të nxënësve dhe studentëve, u propozon masa për largimin nga vendi i punës, nëse në bazë të fakteve gjatë kryerjes së mbikëqyrjes ka vërtetuar se ekziston dyshim me bazë se drejtori ka bërë cenim nga paragrafi 1 i këtij ligji.

### **Neni 31**

Për mbikëqyrjen e kryer, për gjendjet e konstatuara, për veprimet e ndërmarra dhe për masat e ndërmarra, inspektori arsimor përpilon procesverbal.

Në qoftë se inspektori i arsimit konstaton se nuk zbatohen ligjet, rregullat dhe aktet tjera, merr vendim me të cilin urdhërohet zbatimi i masave të caktuara në afat të caktuar të cilin e përcakton inspektori, i cili afat nuk mund të jetë më i gjatë se tetë ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Procesverbalin dhe vendimin, inspektori shtetëror i arsimit ia dërgon institucionit edukativo-arsimor, konviktit të nxënësve dhe studentëve, institucionit të arsimit sipëror dhe shkencor ku është realizuar mbikëqyrja inspektuese, Ministrisë së Arsimit dhe

Shkencës dhe drejtorit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, në afat prej tetë ditësh nga dita e mbikëqyrjes inspektuese të realizuar.

Procesverbalin dhe vendimin, inspektori i autorizuar arsimor, ia dërgon institucionit edukativo-arsimor, konviktit të nxënësve ku është realizuar mbikëqyrja inspektuese, Këshillit të komunës gjegjësisht Këshillit të Qytetit të Shkupit, në afat prej tetë ditësh nga dita e mbikëqyrjes inspektuese të realizuar.

Institucioni nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, në të cilin është realizuar mbikëqyrja, është i obliguar që për masat e ndërmarra për mënjanimin e mangësive në punë, të urdhëruara me vendimin, ta lajmërojnë inspektorin përgjegjës në afatin e dhënë nga dita e pranimi të vendimit.

### **Neni 32**

Kundër aktvendimit të inspektorit mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit.

Ankesa nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Për ankesën kundër vendimeve të inspektorit shtetëror të arsimit, përkatësisht inspektorit të autorizuar të arsimit vendos Komisioni Shtetëror i Vendimmarrjes në Procedurë Administrative, në Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe të Mbikëqyrjes Inspektuese në Shkallë të Dytë..3

### **Neni 33**

Nëse inspektori i arsimit në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese vërteton se me shkeljen e ligjit apo dispozitës tjetër është kryer kundërvajtje, do të kumtojë gjobë në procedurë mandatore.

Nëse gjoba nga paragrafi 1 i këtij neni nuk paguhet në afatin e caktuar, inspektori i arsimit do të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

Nëse inspektori i arsimit në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, vërteton se me shkeljen e ligjit apo dispozitës tjetër është kryer veprë penale, do të ngrit aktpadi për kryerjen e veprës penale.

Organi të cilit i është parashtruar kërkesa, përkatësisht aktpadia nga paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, është i obliguar që vendimin e tij ta dorëzojë te inspektori i arsimit.

### **Neni 34**

Inspektori arsimor, kur gjatë realizimit të mbikëqyrjes inspektuese, do të konstatojë cenim të ligjit ose rregullit tjetër mbi zbatimin e të cilave e realizon mbikëqyrjen ndonjë organ tjetër i administratës shtetërore, është i obliguar për këtë ta lajmërojë organin kompetent të administratës shtetërore.

### **Neni 35**

Inspektori arsimor është përgjegjës në qoftë se:

- 1) gjatë mbikëqyrjes, me vendim nuk urdhëron ndërmarrje të masave dhe veprimeve të cilat sipas ligjit ka qenë i obliguar t'i ndërmarrë;
- 2) i tejkalon autorizimet e tij ligjore;
- 3) e keqpërdor detyrën zyrtare;
- 4) nuk paraqet fletëparaqitje gjegjësisht nuk i lajmëron organet kompetente për parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara;
- 5) nuk legjitimohet para fillimit të mbikëqyrjes inspektuese.

Procedura për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore të inspektorit udhëhiqet në përputhje me Ligjin për nëpunës shtetëror.

## **9. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE**

### **Neni 36**

Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse nuk mban e-ditar në bazë javore në shkollën fillore dhe të mesme.

Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

Gjobë në shumë prej 40 deri në 60 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse nuk mban e-ditar në bazë javore në shkollat fillore dhe të mesme.

Gjobë në shumë prej 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- inspektorit nuk i mundëson kryerje të papenguar të mbikëqyrjes (neni 19),
- inspektorit nuk i mundëson në afatin e caktuar qasje në hapësirat, dokumentet dhe të dhënat e nevojshme që janë lëndë e mbikëqyrjes inspektuese (nenet 28 dhe 29),
- nuk vepron sipas kërkesës, përkatësisht urdhëresës së inspektorit (neni 31) dhe
- inspektorit në afatin e përcaktuar nuk i dorëzon ose përgatit të dhëna të sakta dhe të plota, raporte, materiale ose dokumente tjera që janë të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.



Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së matur për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 4 i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

Gjobë në shumë prej 320 deri në 375 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik të punësuar në personin juridik për veprimet nga paragrafi 4 i këtij neni.

### **Neni 36-a**

Mjetet nga gjobat e shqiptuara në procedurë me lëshimin e urdhëresës pagesore për kundërvajtje nga ana e inspektorëve shtetërorë të arsimit janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, ndërsa mjetet nga gjobat e shqiptuara në procedurë me lëshimin e urdhëresës pagesore për kundërvajtje nga ana e inspektorëve të autorizuar të komunave dhe të qytetit të Shkupit janë të hyra të komunave dhe qytetit të Shkupit.

### **Neni 36-b**

Matja e lartësisë së gjobës për person juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.

### **Neni 36-v**

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji, Inspektorati Shtetëror i Arsimit është i detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhëresë pagesore për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Nëse kryerësi e pranon urdhëresën pagesore për kundërvajtje, të njëjtin duhet ta nënshkruajë. Pranimi i urdhëresës pagesore për kundërvajtje nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

Në procesverbalin nga paragrafi 2 i këtij neni, konstatohet mënyra në të cilën do të mënjahohen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e kryer.

Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhëresën pagesore për kundërvajtje e nënshkruan personi përgjegjës në personin juridik ose nga ai personi i autorizuar.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit është i detyruar që të mbajë evidencë për urdhëresat pagesore për kundërvajtje dhe për rezultatin nga procedurat e ngritura.

Në evidencën nga paragrafi 5 i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhëresës pagesore për kundërvajtje që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 6 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës i përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhëresës pagesore për kundërvajtje.

## **10. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 37**

Ministri, më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi, do t'i nxjerrë rregullat, nxjerrja e të cilave është përcaktuar me këtë ligj.

### **Neni 38**

Me ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi, pushon plotfuqishmëria e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 33/95).

### **Neni 39**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

## **DISPOZITA NGA LIGJET PËR NDRYSHIM DHE/OSE PLOTËSIM**

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011):

### **Neni 9**

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 164/2013):

### **Neni 7**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

### **Neni 4**

Drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të

këtij ligji vazhdon ta ushtrojë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është i emëruar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

**Neni 6**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse dispozitat nga neni 1 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj që do të fillojnë të zbatohen pas dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 33/2015):

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për ndalim dhe pengim të kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 199/14).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/2015):

**Neni 5**

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/2015):

**Neni 7**

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

**Neni 3**

Dispozitat nga neni 5 paragrafi (3) pika 5) nga Ligji për inspeksionin e arsimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 52/2005, 81/2008, 148/2009, 57/10, 51/11, 24/13, 137/13, 164/13, 41/14, 33/15, 145/15 dhe 30/16) dhe dispozitat nga neni 1 të këtij ligji me të

cilin neni 5 paragrafi (3) pika 5) plotësohet me aline të re 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator të vitit 2018.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

**Neni 4**

Drejtori i cili është emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator të vitit 2018, është i obliguar ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Drejtorit i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për inspeksionin arsimor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 3/2025):

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit të tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Ve